



Opština Klokot/Komuna e Klokot

Bazë të nenit 43.pika (43.1,43.2,43.3,43.4,43.5)Ligjit për Qeverisje Lokale 03/L-040,si dhe statutit komunal sipas nenit 18.Është mbajtur séance e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal Klokot për vitin 2019 , me rendin e ditës të përcaktuatr .Me atë rastë është bër si në vijim:

PROCESVERBAL NGA SEANCA E NJËMBËDHJETË E RREGULLT E KUVENDIT KOMUNAL KLOKOT PËR VITIN 2019

Seanca e njëmbëdhjetë e kuvendit komunal është mbajtur me datë 26.12.2019 duke filluar nga ora 11h në lokalitetet e “ Shtëpia e Kulturës “ në Klokot

Kryesuesi I Kuvendit Zarko Dejanovic e udhëheqi seancën .

Afati për dorzimin e materialit ishte në kohë të paraparë ligjore I cili I është shpërndarë delegatëve për shqyrtim . Kryesuesi në pajtim me ligjin për Qeverisje Lokale dhe Statutitn komunal ka mbajtur seancën e Njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit komunal.

Sipas ingjizimit me audiofon , ky procesverbal është nxjerrë nga seanca e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit dhe me atë rast kryesuesi Zarko Dejanovic tha :

Përsëndetje të gjithëve, mire se keni ardhë në seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të |Kuvendit Klokot-Vërbovc.

Të dashur delegatë, unë po hap seancën e njëmbëdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunale. Unë kërkoj falje, para së gjithash, për vonesën e vogël të keqkuptimit ,në të ardhmen shpresoj se nuk do të ndodhin gabime .

Para se të filloj, dua të përsëndes të gjithë delegatët, drejtorët, përfaqësuesit e OSBE-së, qytetarët e pranishëm natyrisht dhe kryetarin e komunës.Delegatë të nderuar, si në çdo seancë, do të bëjnë një thirrje për të përcaktuar kuorumin për punën e sotme të Kuvendit - pasi thirrja u bë nga kryetari i Kuvendit, Dejanovic u konstatua se është kuorumi për punën e sotme të kuvendit.

Zotërinj, delegatë, si në q’do seancë, shpresoj se keni marrë materialin e nevojshëm për seancën e Kuvendit, kështu që dëshiroj t’ju pyes nëse dikush dëshiron ndryshim apo plotësim në rendin e ditës së sotme ?

Pasi askush nuk e dëshiron fjalën , po e jap në votiom . Kush është për miratimin e rendit të ditës së sotme ?

Konstatohet se me shumicë votash kemi miratuar rendin e ditës . Tani po kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës , ajo është :

1. Miratimi i procesverbalit nga seance e dhejtë e rregullt e Kuvendit Komunal për vitin 2019 ;

Nëse dikush dëshiron diçka për të thënë urdhno : Nëse jo po e jap në votim dhe miratim pikën e parë . Kush është për ?

Konstatohet se me shumicë votash është aprovuar pika e parë e rendit të ditës me 11 për . Kalojmë në pikën e dytë , ajo është :

Nëse ka dikush diçka për të thënë urdhoni : Nëse nuk e dëshiron askush fjalën po e jap në votim pikën e dytë ajo është ?

2. Miratimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2010 ;

Të nderuarë delegate dëshiroj të ju njoftoj se ne në seancën e kaluar të kuvendit kemi formuar grupin punues për përpilimin e planit të punës Kuvendit , ku unë si kryesues i kam ftuar si antarë Njaziun , Naserin , Dragishën dhe Unë , drejtoresha ishte por është tërhequr , e keni pranuar hartimin e planit , e keni parë si duket , nëse dikush dëshiron diçka për të thënë urdhnoni.

Hidajeti: I nderuarë kryetarë , kryesues , drejtor , delegatë , përfaqësues të OSBE –së dëshiroj të ndërlidhem për disa pika lidhur me Planin e punës së Kuvendit nëse mund të ndryshojmë diçka nga muaji në muaj , do të thotë në Janar duhet të përfshihen prezentimet e prokurimit . Ndërsa pika e dytë informimi për shkollë që është planifikuar në Shkurt do të duhej të ishte në JANAR . Unë mendoj se ka kohë për të mbledhur informata , kam edhe një propozim të jetë pikë e rendit të ditës informimi dhe mirmbajtja e rrugëve në teritorin e komuns së Klokotit për muajin Janar .

Kryesuesi : Zotëri Hidajet ky është Përpilim i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2020 propozimi i juaj është me vend por kjo nuk është e fiksuar se këto pika janë patjetër mund edhe të ndryshohen dhe të bëhen në Janar siq po kërkon ju ky nuk është aspak problem , tani është në pyetje që kjo të miratohet formalisht ndërsa për pika gjithmonë mund të marrëshemi për të hyrë në rend dite nuk është problem. Ju ndoshta nuk ishit në seancën e kaluar dhe nuk jeni të njoftuar aty kanë marrë pjesë zotri Naseri dhe zotëri Njaziu . Kush është PËR miratimin e pikës së dytë të rendit të ditës ? Konstatohet se me 10 vota për 1 apstenim dhe tre nuk janë deklaruar kemi miratuar këtë pikë.

Kalojmë në pikën e tretë , ajo është :

3.Marrja e vendimit për anulimin e vendimit të Kuvendit me numër 1269\2 për Rregulloren për pagesat e tatimit në pronë të palujtshme për vitin 2020 . dhe dokumentet e rregullores për pagesa të tatimit në patundshmëri me numër 1270\2 e arhivuar në arhivën komunale me 30 09 2019 .Pas vlerimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së financave këtë vendim duhet ta anulojmë . Zotëri delegate ju e dini se gjdo vendim që ne marrim e dërgojmë në Ministrinë e Pashqytetit Liokal gjegjësisht në zyrën Ligjore .

Në mënyrë që të veprojmë në përputhje me ligjin e Ministrisë për financa këtë vendim duhet tas anulohet . Kush është për . Konstatohet se me 12 vota për kemi anuluar vendimin me numër 1269\2 .Kalojmë në pikën e katërt .

4. marrja e vendimit për anulimin e vendimit të Kuvendit komunal me nr. 1297\2 për përgesën e ndriqimit public për Njësinë e kishës Sveti Nikola në Grnqar e arhivuarë në arhivën komunale me datë 03 10 2019 .Pas vlersimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Financave se nuk është në përputhje me ligjin . Të nderuarë në mënyrë që edhe kjo të jetë në përputhje me ligjin edhe këtë vendim duhet ta anulohet , unë mendoj se nuk duhet të ju arsyetoj asesi , validitetin e vlerësimit Ministria e financave . Kush është për anulimin e këtij vendimi ?

Konstatohet se pikën e katërt të rendit të ditës e kemi anuluar vendimin me 12 vota për . Kalojmë në pikën e pestë .

5. Miratimi i vendimit për anulimin e vendit të Kuvendit komunal me nr. 1298\2 për destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore e arhivuarë në arhiveën komunale me 03 10 2019 pas vlersimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural se nuk është në përputhje me ligjin ;

Të nderuarë delegatë edhe ky vendim duhet të anulohet , kush është për anulimin e këtij vendimi ?

Konstatohet se me njëmbdhjet vota për kemi anuluar vendimin me numër 1298/2 për destinimin e tokave bujqësore . Kalojmë në pikën e gjashtë .

6.Propozim i Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 10440 \ 2 të Kuvendit Komunal për zëvendësimin e anëtarëve për sigurinë e komunitetit;

Dëshiron ndonjëri fjalën? Urdhnoni zoti Stojilkovic

Stojilkovic:Përsëritës të gjithë të pranishmit dëshiroj të ju uroj vitin e Ri ju uroj gëzim , unë jam lajmëruar për këtë pikë edhe herën e kaluarë edhe sot jam në qëndrim të njëjtë dhe jam kundër asaj që Danjel Stojkovic të zëvendësohet me antarë tjetër derisa të kryhet procesi gjyqësor . Kjo do të thotë se jam kundër këtij vendimi .

Petkovic : Mirdita të gjithëve , përsëritës për të gjithë të pranishmit. Unë gjithashtu jam paraqitur në seancën e kaluarë sa i përket kësaj pike kështu që pajtohem me zotëri Stojkovic siq edhe e kam thënë herën e kaluarë , qëndrimet nuk ndryshojnë .

Sasa Mirkovic : Pasqerë gjithash të gjithë juve të pranishëm ju përsëritës , unë e di se ju në seancën e kaluarë keni shqyrtuar për këtë pikë të rendit të ditës e di që komisioni për siguri në komunitete në komunë është shumë i rëndësishëm dhe aji duhet sipas ligjit të jetë në përbërje të plotë gjithnjë sepse këtu bëhet fjalë për komunitete por duke e dëgjuar Stojilkoviçin dhe Petkoviçin konsideroj se në seancën e kaluarë , konsideroj se se është më mirë të presim që të përfundoj procesi gjyqësor të shohim

cilatë janë rezultatet e gjykatës dhe më pasë të bëjmë plotësime dhe ndryshime në këshillin komunal për komunitete vetëm këtë po e them para udhëheqsisë se është më së miri ashtu .

Kryesuesi : Zotërinjë e keni ndëgjuarë nënkryetarin dhe dy delegatët e vetmja që mbetet është ta jap në votim që kjo pikë të shtyhet deri në përfundim të procesit gjygsor . Kush është për shtyerjen e kësaj pike ?

Konstatoj se me shumicë votash kemi shtyrë pikën e gjashtë të rendit të ditës .

7. Propozim –Vendim për dhënjen e pëlqimit të Kuvendit për zbatimin e procedurave për destinimin e tokës nga bujqësore në ndërtimore për parcellën P- 73701026-00548-0 në sipërfaqe 513 m2 në emër të pronarit Kosum Zeqiri (Mustaf) zona katastrale Klllokot .

Nëse dëshiron dikush të thotë diqka urdhno .

Hidajeti: Për këtë pikë duhet të kemi në parasysh ku janë refuzuan për seancën e fundit, nuk është e mirë as si komunë dhe as Kuvend komunal që marrin vendime sepse ato tashmë kanë kaluar në shërbimin juridik, duhet të kemi parasysh pasi ne si këshilltarë kemi një përgjegjësi të madhe. Pra , ne po ngrejm dorën për diqka që nuk është në pajtim me ligjin .Nuk kmë asgjë kundër vetëm se duhet të ti respektojmë procedurat ligjore.Kryesuesi shtoj se ne duhet të kryejmë punën tonë e ata punën e tyre , pastaj e dha në votim pikën e shtatë , kush është për miratimin e kësaj pike?

Konstatoj se pikën e shtatë e kemi miratuarë me 10 vota për , kundër nuk kishte një apstenim tre delegatë nuk u deklaruan . Kalojmë në pikën e tetë .

8. Propozim –Vendim për dhënjën e pëlqimit të kuvendit komunal për zbatimin e procedurave ligjore për destinimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore në tërësi të parcellës me numër P-73701026-01155-2 në emër të pronarit Lazar Cvetkovic (Petar) zona katastrale Klllokot ;

Kjo është e njehta të nderuarë delegatë në qoftëse është e jashtligjshme ajo do të kthehet por aty është ministria e pushtetit lokal e cila bën vlersimin e ligjshmërisë , kush është për miratimin e kësaj pike të rendit të ditës ?

Konstatoj se pikën e shtatë e kemi miratuarë me 10 vota për , kundër nuk kishte një apstenim tre delegatë nuk u deklaruan . Kalojmë në pikën e nëntë .

9.Propozim vendim për dhënjën e pëlqimit Kuvendi komuna Kryetarit të komunës lidhur me bisedimet dhe ofertat e palëve të interesuara për përgaditjen të propozimit final nga ana e kryetarit të komunës për dhënjën e pronës komunale në shfrytëzim për miratim përfundimtarë në kuvend komunal ;

Hidajeti: Unë e di se ky rastë është specifik ligji I për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale jep mundësin kryetarit të komunës të negocioj por në mënyren se si është paraqitur pronari me kërkesë , unë mendoj se është e kundërligjshme sepse I takon komunës të bëjë ofertën , Kryesuesi tha se kjo është vetëm dhënjë e pëlqimit që dikush të bisedoj të gjitha të tjerat do të jenë në pajtim me ligjin , do të jenë në seancat e kuvendit për shqyrtim për secilin rast .

Hidajet: Nana Naile e ka deri në vitin 2028 për shfrytëzim deri sat ë kaloj ky afat aji nuk ka të drejtë të paraqitet në komunë për ta vazhduarë , dhe tjetra tek rasti I Nana Naile nuk ka konkurrencë sepse aji vetëm se po e shfrytëzon pronën dhe unë mendoj se nëse ne e votojm për këtu unë mendoj se do të kthehet si e pavlefshme

Mirkovic: Po të kuptoj Hidajet në tërsi , ne për këtë pikë të rendit të ditës kemi pranuarë tri kërkesa nga ana e pronarit të Nana Naile , nuk jemi përgjigjur në dy kërkesa dhe më pastaj na kanë thirrë nga Ministrija e pushtetit lokal dhe ne para dhjetë ditëve kemi shkuar në konsultime të shërbimeve juridike të pushtetit lokal sepse ne si qeverisje lokale jemi të obliguarë të punojmë me biznesmenët me qytetarët tanë dhe gjithqka që kontribon në në të mirë komunën tonë të Kllkotit .

Ne shumë mirë e dijmë se në komunë kemi pronë e cila shfrytëzohetë tetëdhjetë për qind dhe askush nuk e paguanë asnjë cent , si subjektet private edhe ato juridike , sikurse të gjithë ta respektonin ligjin edhe kur të kishin paguarë qiran bugjeti komunal do të ishte shumë më I madhë .Mbas bisedimeve në Ministri neve na është thënë nga ana e shefit të shërbimeve juridike që kuvendi do t ë thotë delegatët të miratojnë vendimin dhe ti japin autorizim kryetarit që aji përmes aktiviteteve juridike në të ardhmen të kryej pjesën e punës së tijë . E di që tani ligji I ri jep shumë autorizime të forta kryetarit për pronat komunale dhe se tani është shumë më lehtë dhe se nuk është shumë e komplikuarë me procedura por ne duhetë të shohim se sit i daslim në ndihmë përmes këtyre vendimeve dhe të jkapim përgjigje në kërkesat e qytetarëve tanë .Marrveshja në mes të Ministrisë së Pushtetit lokal dhe qytetarëve tanë ka qënë që ti ipet mbështetja dhe autorizimi kryetarit të komunës lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ku aji më pasë do ta shqyrtoj me shqërbimin e tijë juridik vendimin të cilin do ta miratojmë në Ministri dhe nëse është në [përputhje me ligjin pastaj bëhet në procedurë të drejtë ligjore .

Kryesuesi : edhe ky vendim nëse miratohetë Ministrija e Qeverisjes Lokale do të vërtetoj validitetin ky nuk është vendim ky është vetëm Autorizim që kryetari me shërbimin juridik të shohin se kush e shfrytëzon pronën dhe kush e paguan.

Naseri : Përhëndetje për të gjithë të pranishmit , së pari do të ju dëshiroja që për këtë vit tëni shumë shëndet dhe ne të kalojmë shkelqyshem unë do të ndërlihem për këtë pikë që flasim për ligjet , ndoshta ne në komunë kemi jurist I cili do të interrpertoj këtë ligj siq duhet , unë do të propozoj që nëse është për të mirën e qytetarëve pse atëherë ne mos t a votojmë.

Kryesuesi e dha në votim pikën e nëntë të rendit të ditës , kush është për?

Konstatohet se kemi miratuarë pikën e nëntë të ditës më 9 vota për , 2 kundër tre delegatë nuk u deklaruanë .

10. të ndryshme

kryesuesi ju uroj të gjithve vitin e Ri dhe bozhiqet pë rata të cilët I festojnë .

Hidajeti: gjithashtu ju uroj Vitin e Ri dhe bozhiqin , e kam një pyetje lidhur me një rast në Mogill tek rruga zakutit sigurisht e dini se kanë filluarë ta asfaltojnë por një gjë e quditdshme një rrugë e cila shpije në

rrugën kryesore ku janë tre apo katër familje shqiptare ku një pjesë e rrugës vetëm se është pregaditur për asfaltim por akoma nuk është asfaltuarë .Unë si delegate I kuvendit komunal kërkoj të kamë qasje në dokumentet publike kuptohet edhe në projektet dhe në realizimin e këtij projekti , me qen ktu kryetari ose drejtori I financave mesiguri kishin dhene ndonje sqarim lidhur me këtë. Për këto katër familje të komunitetit shqiptat këta janë pjesë e kësaj rruge këta persona kanë ardhur tek unë dhe janë ankuarë për këtë rast I kamë edhe fotografitë të cilat mi kanë dërguar . Unë si delegate jamë I interesuarë për këtë rast dhe dua të dijë ku është problem , sepse familjarët mendojnë se janë të diskriminuarë , ajo rrugë është për të gjithë qytetarët dhe për këtë dua të kamë qasje në dokumentet publike .

Mirkovic e pyeti Hidajetin , kush është ajo famije pasi që diqka kemi shqyrtuar , kush jeton aty , ku jeton Rexha edhe aty janë të papërfunduara rreth 50 m , sepse e di se aty e kemi bërë ndriqimin rrugor ndërsa asfaltimi do të bëhetëe vitin e ardhshëm , ndërsa për këtë nuk e dijë do të pyes po mundemi sot të shofim se qka është në pyetje .

Hidajeti: Edhe rasti I shkollës në Mogillë unë disa herë e kamë përmendur këtë rast dhe janë të njoftuarë edhe përfaqsesit e OSBE-së edhe nënkryetari I cili është këtu I cili më ka premtuarë se nxënësit shqiptarë në fillim të këtij viti do të kthehen në shkollën e vjetër , mendoj se do të ishjte mirë për bashkpunim multietnik gjithashtu edhe për projekte të cilat I dërgojmë në organizata . Nëse ashtu bëjmë ne mund të mbërrijmë marrveshje të përbashkët dh ti kalojmë kufijtë që I kishim më parë.

Mirkovic: E dijë shumë mirë se kishim aktivitete të përbashkëta sa I përket pastrimit dhe mirmbajtjes së mjedisit dhe ajo ishte një pasqyrë shumë e mirë është punuarë edhe në Vërbovc edhe në Mogillë , kanë punuarë edhe nxënësit Shqiptarë edhe ata serb dhe unë konsideroj se ajo shkollë ishte shembull për mardhënjët multietnike dhe respektim i gjitha komuniteteve në atë periudhë është bërë edhe është adaptuarë shumë qka dhe akoma nuk është perfekte , do të flas me drejtorin e Arsimit edhe unë jamë për që ne duhetë të shoqërohemi përmes sportit dhe arsimit dhe vetëm ashtu mund të shkojmë përpara . Dhe në fund ju dëshiroj më të mirat për 2020 të keni shume shëndet dhe të gjitha tjerat janë kaluese .

Kryesuesi pyeti a e dëshiron edhe dikush fjalën në pikën të ndryshme ? Pasi askush nuk u paraqit e mbylli seancën e sotme . Ju faleminderit .

Data:26.12.2019

Kruesuesi I Kuvendit Komunal Klllokot Vërbovc

Zarko Dejanovic

